

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Yjet jashtë dhe rikthimet e bujshme, Spanja dhe Anglia publikojnë listën e lojtarëve të thirrur për Ligën e Kombeve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/yjet-jashte-dhe-rikthimet-e-bujshme-spanja-dhe-anglia-publikojne-listen-e--i586873
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:02:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6abe4dbb483df182aadbc38b3ce3fcf57b09c111a38b5aa86347d94ed44ece
TEKSTI	a38649d5e6c1943a72205ca30d348736d85d169b65a314f3b2c6548eb8db4ac1
PAMJA	55bf749941bee3757f07d384a9380ac16b6eddd3a85d316ad16f6eeb1c33fc17

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab1648e371709c8a2f3a17973dec9dd7b0da957a85034e0446197666472c8a30
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab1648e371709c8a2f3a17973dec9dd7b0da957a85034e0446197666472c8a30>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Reagojne avokatet e huajt te Veliajt, Kasowitz, Vendimi i Gjykes se Larte eshte katkian, ve ne prove nese kontrolli kushtetues ka fuqi praktike i akimi sekret ne Buenos fundit

Yjet jashtë dhe rikthimet e bujshme, Spanja dhe Anglia publikojnë listën e lojtarëve të thirrur për Ligën e Kombeve



18 Shtator 2026, 14:50Sport TEMA



Një përballje që garanton emocione me gjigantë të futbollit botëror që do të zbresin në fushë. Spanja dhe Anglia do të përballen së bashku në Ligën e Kombeve në duelin që do të luhet në Wembley.

Së fundmi, dy trajnerët kanë publikuar dhe listën e lojtarëve të thirrur. Kampionja e botës, Spanja e Luis de la Fuente, ruan pjesën më të madhe të grupit që ngriti trofeun në verë, por disa emra të njohur mungojnë.

Jashtë listës kanë mbetur Gavi dhe Borja Iglesias, ndërsa portieri Joan García mungon për shkak të dëmtimit. Jashtë ka mbetur dhe Marcos Llorente, i cili prej disa kohësh, ka njoftuar tërheqjen nga kombëtarja.

Surpriza është portieri i Interit, Josep Martínez, që merr për herë të parë ftesën, ndërsa rikthehen në kombëtare Huijsen dhe Fermín López, ky i fundit pasi humbi Botërorin për shkak të dëmtimit. Një tjetër emër i ri është sulmuesi Roberto Fernández, i cili ka nisur sezonin me gjashtë gola për Espanyol.

Spanja do ta nisë aventurën në Ligën e Kombeve pikërisht ndaj Anglisë, më 26 shtator në Wembley. Edhe Thomas Tuchel ka bërë një revolucion te Anglia. Trajneri gjerman ka grumbulluar 27 lojtarë dhe ka bërë dhjetë ndryshime krahasuar me grupin e Botërorit.

Rikthimi më i bujshëm është ai i Trent Alexander-Arnold, i cili vjen sërish në kombëtare që prej qershorit 2025. Nga ana tjetër, dy emra me shumë peshë mungojnë: John Stones dhe Jordan Henderson.

Dueli me Spanjën në Wembley më 26 shtator do të jetë prova e vërtetë e teknikut Tomas Tuhel, përpara ndeshjeve me Çekinë dhe Kroacinë. Dy gjigantë të futbollit botëror takohen menjëherë në start të Ligës së Kombeve, në një përballje që garanton emocione të mëdha deri në fund.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Arbër Hoxha transferohet në Emiratet e Bashkuara, Al Wahda i paguan Dinamos 2.5 mln euro](#)

12:30 Sport

Kombëtarja nis përgatitjet për UEFA Nations League, trajneri Maran shpall të shtunën listën e të grumbulluarve

10:50 Sport

[Ndahet nga jeta Esat Bushati, legjenda e Vllaznisë/ Beci: Futbolli shkodran humbi sot një nga emrat e tij të respektuar](#)

16:55 Sport / 2 komente

[Brazil, presidenti Lula i bën apel Ancelottit: Merr më shumë futbollistë që luajnë në kampionatin tonë](#)

13:00 Sport



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.